

SPECIFIKIME TEKNIKE

Objekti : Punime restaurimi në fasadën e Muzeut Kombëtar të Fotografisë “Marubi”

1. Çmontim dyer dritare

Ky çmim jepet në lek/m² dhe përfshin heqjen në këtë rast nga murtaura të cdo lloj dritareje, derye dhe grile të specifikuar në projekt. Heqja e deryeve, dritareve dhe grilave do të bëhet me kujdes në mënyrë që të mos dëmtohet muratura.

2. F.V Dyer te jashtme cilesia e I-re spesor mbi 5 cm (iroko)

Furnizimi i deryeve do kryhet nga kontraktori përkatës nga vendi i prodhimit ose blerjes deri në objekt. Dyeret do të jenë riprodhim i derës së vjetër përkatëse ne konceptin e formes dhe dimensioneve. Materiali i drurit do te jete iroko importi e cilesise se pare. Furnizimi dhe vendosja e deryeve domosdoshmerisht do te shoqerohet me certifikaten perkatese te cilesise. Te mos vendosen dyert e drurit pa aprovimin e mbikeqyresit perkates nepermjet nje proces-verbali per miratim materialesh. Te kihet parasysh se dyert do te jene dopio xham. Në rast mungese të një detaji për zevendesimin e deryeve te drurit, detaji do të aprovohet nga supervizori.

- **Përshkrimi:** Derë masive e jashtme, riprodhim i modelit ekzistues historik.
- **Materiali:** Iroko lamelar me faqe të dukshme të zgjedhura për uniformitet fibre (rift-sawn).
- **Trajtimi Sipërfaqësor (Cikli i Lyerjes):**
 1. Pastrim me tretës (acetone) për largimin e vajrave sipërfaqësorë para lyerjes.
 2. Aplikim i impregnesit fungicid me bazë uji.
 3. Aplikim i dy duarve vaj impregnes me filtër UV (tip Osmo UV-Protection Oil Extra 420 ose ekuivalent). Ky trajtim mikroporoz lejon drurin të "marrë frymë" dhe nuk krijon cipë që rripet, duke lehtësuar mirëmbajtjen e ardhshme.
- **Montimi:** Fiksimit në muraturë me kasa false ose ankorues kimikë, duke evituar kontaktin direkt me lagështinë e murit.

3. F.V Dritare druri e stazhionuar e pergatitur dopio xham

Furnizimi i dritareve do kryhet nga kontraktori përkatës nga vendi i prodhimit ose blerjes deri në objekt. Dritaret do të jenë riprodhim i dritares së vjetër përkatëse ne konceptin e formes dhe dimensioneve. Materiali i drurit do te jete iroko importi e cilesise se pare. Furnizimi dhe vendosja e dritareve domosdoshmerisht do te shoqerohet me certifikaten perkatese te cilesise. Te mos vendosen dritaret e drurit pa aprovimin e mbikeqyresit perkates nepermjet nje proces-verbali per miratim materialesh. Te kihet parasysh se dritaret do te jene dopio xham. Në rast mungese të një detaji për zevendesimin e dritareve te drurit, detaji do të aprovohet nga supervizori.

- **Materiali:** Dru tropikal Iroko (*Milicia excelsa*), Cilësia Superiore (FAS), i tharë teknikisht (Kiln Dried) në lagështi 12% ± 2%.

- **Struktura e Profilit:** Profil lamelar me tre shtresa të ngjitura (DKD) për të neutralizuar tensionet e brendshme. Seksioni i profilit **78x80mm (Sistemi IV78)**.
 - *Shënim:* Përdorimi i profilit 78mm (kundrejt standardit të vjetër 68mm) është i domosdoshëm për të akomoduar xham termik me performancë të lartë dhe për të rritur qëndrueshmërinë statike të kanateve të larta.
- **Ngjitësi:** Përdorimi i detyrueshëm i ngjitësit **Poliuretanic D4 (PU)** ose Poliacetat D4 me katalizator, rezistent ndaj ujit dhe temperaturave të larta (EN 204), duke pasur parasysh vajrat natyralë të Irokos.
- **Dizajni:** Riprodhim besnik i gjeometrisë së jashtme, ndarjeve dhe profileve dekorative ("kornizave") të dritareve origjinale të Idromenos. "Pika e ujit" (Drip cap) në pjesën e poshtme të jetë e integruar në dru ose alumin i veshur për të evituar rrjedhjen e taninës në fasadë.
- **Mekanizmi:** Hapje me rrotullim dhe devijim (Tilt & Turn) me mbyllje perimetrale shumë-pikëshe (Roto/Maco) për siguri maksimale.
- **Xhami:** Paketë termike dopio xham (44.2 Low-E / 16 Argon / 4), me shtresë të laminuar për filtrimin e rrezeve UV (mbrojtje e eksponateve muzeale).

4. F.V Grila Druri (iroko)

Furnizimi i grilave do kryhet nga kontraktori përkatës nga vendi i prodhimit ose blerjes deri në objekt. Grilat do të jenë riprodhim i griles së vjetër përkatëse në konceptin e formës dhe dimensioneve. Materiali i drurit do të jetë pishë e kuqe importi e cilesisë së parë. Furnizimi dhe vendosja e grilave domosdoshmërisht do të shoqërohet me certifikatën përkatëse të cilesisë. Të mos vendosen grilat e drurit pa aprovimin e mbikeqyresit përkatës nepermjet një proces-verbali për miratim materiale. Në rast mungese të një detaji për zëvendësimin e grilave të drurit, detaji do të aprovohet nga supervizori.

- **Materiali:** Dru Iroko masiv, Cilësia I.
- **Konstruksioni:** Kornizë druri me bashkime "mortise and tenon" (mashkull-femër) të ngjitura me D4 dhe të fiksuara me pyka druri.
- **Fletët:** Fletëza të profiluara Iroko, të fiksuara me inklinim për mbrojtje nga dielli dhe shiu, por duke lejuar ajrosjen.
- **Aksesorët Metalikë:** Të gjitha menteshat, rezet dhe vidat duhet të jenë **Inoks i Klasit A4 (AISI 316)** ose Tunxh.

Kujdes: Ndalohet rreptësisht përdorimi i hekurit të zinkuar, pasi Iroko reagon kimikisht me hekurin duke krijuar njolla të zeza të pashlyeshme në dru

Punoi: Fatjon Mlloja

Sabrina Kuçi

Elson Laqja

Oltion Çuni

Miratohet :

Petrit Bilali

Drejtor

Helidon Sokoli

